FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 38 **Datë 26 mars 2014**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 18/2014 datë 27.2.2014	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Vjenës "Për të drejtën e traktateve midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose midis organizatave ndërkombëtare", 1986….	931
Ligj nr. 22/2014 datë 10.3.2014	Për dhënie amnistie	949
Urdhër i Kuvendit nr. 1, datë 26.3.2014	Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë	951

LIGJ
Nr. 18/2014

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E VJENËS "PËR TË DREJTËN E TRAKTATEVE MIDIS SHTETEVE DHE ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE OSE MIDIS ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE", 1986

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e Vjenës "Për të drejtën e traktateve midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose midis organizatave ndërkombëtare", 1986.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.2.2014

Shpallur me dekretin nr. 8519, datë 13.3.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani

KONVENTA E VJENËS
PËR TË DREJTËN E TRAKTATEVE MIDIS SHTETEVE DHE ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE OSE MIDIS ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE 1986
VJENË MË 21 MARS 1986. NUK KA HYRË ENDE NË FUQI

Shiko të dhënat zyrtare të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e traktateve midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose midis organizatave ndërkombëtare, vol. II (publikimi i Kombeve të Bashkuara Sales No. E.94.V.5).

Palët në këtë Konventë,

duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm të traktateve në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare;

duke njohur natyrën konsensuale të traktateve dhe rëndësinë e tyre gjithmonë e në rritje si burim i së drejtës ndërkombëtare;

duke vënë në dukje se parimet e pëlqimit të lirë, të mirëbesimit dhe të rregullit të *pacta sunt servanda* (lat. marrëveshjet duhet të respektohen) njihen botërisht;

duke konfirmuar rëndësinë e rritjes së procesit të kodifikimit dhe të zhvillimit në rritje të së drejtës ndërkombëtare në nivel universal;

duke besuar që kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i rregullave që lidhen me traktatet midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose midis vetë organizatave ndërkombëtare janë mjete të rritjes së rendit ligjor në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe duke i shërbyer qëllimeve të Kombeve të Bashkuara;

duke pasur parasysh parimet e së drejtës ndërkombëtare të mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, siç janë parimet e të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së njerëzve, të barazisë dhe pavarësisë sovrane të të gjitha shteteve, të mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve, të ndalimit të kërcënimeve apo të përdorimit të forcës, të respektit universal dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë;

duke pasur parasysh dispozitat e Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969;

duke marrë në konsideratë rëndësinë e traktateve midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose midis organizatave ndërkombëtare si një mjet i dobishëm i zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i sigurimit të kushteve për bashkëpunim paqësor midis kombeve, pavarësisht nga sistemet e tyre kushtetuese dhe sociale;

duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të traktateve në të cilat organizatat ndërkombëtare janë palë si subjekte të së drejtës ndërkombëtare ndryshe nga shtetet;

duke vënë në dukje që organizatat ndërkombëtare kanë zotësinë për të lidhur traktate, gjë e cila është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe përmbushjen e qëllimeve të tyre;

duke pranuar që praktika e organizatave ndërkombëtare në lidhjen e traktateve me shtetet ose ndërmjet tyre duhet të jetë në përputhje me instrumentet e tyre përbërëse;

duke konfirmuar që asgjë në këtë Konventë nuk duhet të interpretohet që ndikon në marrëdhëniet midis një organizate ndërkombëtare dhe anëtarëve të saj, marrëdhënie të cilat rregullohen nga rregullat e organizatës;

duke konfirmuar gjithashtu që mosmarrëveshjet që lidhen me traktatet, ashtu si mosmarrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duhet të rregullohen në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara me mënyra paqësore dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të së drejtës ndërkombëtare;

duke konfirmuar gjithashtu që rregullat e të drejtës ndërkombëtare të zakonshme do të vazhdojnë të rregullojnë çështje që nuk rregullohen nga dispozitat e kësaj Konvente,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
HYRJE

Neni 1
Qëllimi i kësaj Konvente

Kjo Konventë zbatohet për:

a) traktatet midis një ose më shumë shteteve dhe një ose më shumë organizatave ndërkombëtare; dhe

b) traktatet midis organizatave ndërkombëtare.

Neni 2
Përdorimi i termave

1. Për qëllime të kësaj Konvente:

a) "Traktat" do të thotë një marrëveshje ndërkombëtare e rregulluar nga e drejta ndërkombëtare dhe e realizuar në formë të shkruar:

i) midis një ose më shumë shteteve ose më shumë organizatave ndërkombëtare; ose

ii) midis organizatave ndërkombëtare;

nëse ajo marrëveshje mishërohet në një instrument të vetëm, në dy apo në më shumë instrumente të lidhura dhe pavarësisht emërtimit të saj të veçantë.

b) "Ratifikim" do të thotë një akt ndërkombëtar, përmes të cilit një shtet jep në planin ndërkombëtar pëlqimin e tij që të jetë i detyruar nga dispozitat e një traktati.

(b bis) "Akt i konfirmimit formal" do të thotë një akt ndërkombëtar që i korrespondon aktit të ratifikimit nga një shtet, përmes të cilit një organizatë ndërkombëtare jep në planin ndërkombëtar pëlqimin e saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati.

(b ter) "Pranim", "aprovim" dhe "aderim" do të thotë, në çdo rast, një akt ndërkombëtar, me anë të të cilit një shtet ose një organizatë jep në planin ndërkombëtar pëlqimin e tij/saj për të qenë i detyruar nga dispozitat e një traktati.

c) "Kompetenca të plota" do të thotë një dokument që del nga autoritetet kompetente të një shteti ose nga organi kompetent i një organizate ndërkombëtare që përcakton një person apo disa persona për të përfaqësuar shtetin apo organizatën për të negociuar, miratuar apo vërtetuar autenticitetin e tekstit të një marrëveshjeje, për të shprehur pëlqimin e shtetit apo të organizatës për të qenë i detyruar nga dispozitat e një traktati, apo për të përmbushur çdo akt tjetër në lidhje me një traktat.

d) "Rezervë" do të thotë një deklaratë e njëanshme, pavarësisht se si është e formuluar apo quajtur, e bërë nga një shtet apo nga një organizatë ndërkombëtare kur nënshkruhet, ratifikohet, konfirmohet formalisht, pranohet, aprovohet apo aderohet në një traktat, ku ai synon të përjashtojë ose të modifikojë efektin ligjor të dispozitave të caktuara të traktatit në zbatimin e tyre në atë shtet, ose për atë organizatë.

e) "Shtet negociues" dhe "organizatë negociuese" do të thonë, përkatësisht:

i) një shtet, apo

ii) një organizatë ndërkombëtare,

që ka marrë pjesë në hartimin dhe miratimin e tekstit të marrëveshjes.

f) "Shtete kontraktuese" dhe "organizata kontraktuese" do të thonë respektivisht:

i) një shtet, apo

ii) një organizatë ndërkombëtare,

që ka dhënë pëlqimin që të kufizohet nga traktati, edhe nëse ky i fundit ka hyrë në fuqi ose jo.

g) "Palë" do të thotë një shtet ose një organizatë ndërkombëtare, e cila ka dhënë pëlqimin për të qenë i detyruar nga marrëveshja dhe për të cilën traktati ka hyrë në fuqi.

h) "Shteti i tretë" dhe "organizata e tretë" do të thonë përkatësisht:

i) një shtet,

ii) një organizatë ndërkombëtare,

jo një palë e traktatit.

i) "Organizatë ndërkombëtare" do të thotë një organizatë ndërqeveritare.

j) "Rregullat e organizatës" do të thotë në veçanti, instrumentet përbërëse, vendimet dhe rezolutat të miratuara në përputhje me to si dhe praktika e caktuar e organizatës.

2. Dispozitat e paragrafit 1, që lidhen me përdorimin e termave në këtë Konventë, nuk kanë paragjykim ndaj përdorimit të atyre termave ose ndaj kuptimeve që mund t'u jepen atyre në të drejtën e brendshme të çdo shteti ose në rregullat e çdo organizate ndërkombëtare.

Neni 3
Marrëveshjet ndërkombëtare që nuk janë të përfshira në këtë Konventë

Fakti që kjo Konventë nuk zbatohet për:

i) marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat janë palë një ose më shumë shtete, një ose më shumë organizata ndërkombëtare dhe një apo më shumë subjekte të së drejtës ndërkombëtare përveç shteteve apo organizatave;

ii) marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat janë palë një ose më shumë organizata ndërkombëtare dhe një apo më shumë subjekte të së drejtës ndërkombëtare përveç shteteve apo organizatave;

iii) marrëveshjet ndërkombëtare jo në formën e shkruar midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare, apo midis organizatave ndërkombëtare; apo

iv) marrëveshjet ndërkombëtare midis subjekteve të së drejtës ndërkombëtare përveç shteteve apo organizatave ndërkombëtare;

Nuk do të ndikojë:

a) në fuqinë ligjore të marrëveshjeve të tilla;

b) në aplikimin ndaj tyre të çdo rregulli të parashtruar në këtë Konventë ndaj të cilave ato do të jenë subjekte sipas së drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga Konventa;

c) në aplikimin e Konventës në marrëdhëniet midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare apo në marrëdhëniet e organizatave midis tyre, kur ato marrëdhënie udhëhiqen nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat subjekte të tjera të së drejtës ndërkombëtare janë gjithashtu palë.

Neni 4

Fuqia jo prapavepruese e kësaj Konvente

Pa rënë ndesh me zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë Konventë, në të cilën traktatet midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare apo midis vetë organizatave ndërkombëtare do të jenë subjekt sipas të drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga Konventa, Konventa zbatohet vetëm në ato traktate të lidhura pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me ato shtete dhe ato organizata.

Neni 5

Traktate që konstituojnë organizatat ndërkombëtare dhe traktatet e përshtatura brenda një organizate ndërkombëtare

Kjo Konventë zbatohet për çdo traktat midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare që është instrumenti përbërës i një organizate ndërkombëtare pa rënë ndesh me ndonjë nga rregullat përkatëse të organizatës.

PJESA II

LIDHJA DHE HYRJA NE FUQI E TRAKTATEVE

SEKSIONI 1. LIDHJA E TRAKTATEVE

Neni 6

Aftësia e organizatave ndërkombëtare për të lidhur traktate

Aftësia e një organizate ndërkombëtare për të lidhur traktate drejtohet nga rregullat e asaj organizate.

Neni 7

Kompetenca të plota

1. Një person konsiderohet që përfaqëson një shtet për qëllimin e miratimit apo të vërtetimit të origjinalitetit të tekstit të traktatit apo për qëllimin e shprehjes së pëlqimit të një shteti për t'u kufizuar nga dispozitat e një traktati në qoftë se:

a) ai person ka kompetenca të plota të përshtatshme; ose

b) nga praktika apo nga rrethana të tjera është parë që ai ishte qëllimi i shteteve dhe organizatave ndërkombëtare të interesuara për ta konsideruar atë person si përfaqësues të shtetit për qëllime të tilla pa qenë nevoja të prodhohen kompetenca të plota.

2. Në bazë të funksioneve të tyre dhe pa u dashur të kenë kompetenca të plota, më poshtë konsiderohen që përfaqësojnë shtetin e tyre:

a) kryetarët e shteteve, kryetarët e qeverisë dhe ministrat për çështjet e jashtme, për qëllimin e kryerjes së të gjitha akteve që kanë të bëjnë me lidhjen e një traktati midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare;

b) përfaqësuesit e akredituar nga shtetet në një konferencë ndërkombëtare, me qëllim miratimin e tekstit të një traktati midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare;

c) përfaqësuesit e akredituar nga shtetet në një organizatë ndërkombëtare apo në një prej organeve të saj, me qëllim miratimin e tekstit të një traktati në atë organizatë apo organ;

d) kryetarët e misioneve të përhershme në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim miratimin e tekstit të një traktati midis shteteve akredituese dhe asaj organizate.

3. Një person konsiderohet si përfaqësues i një organizate ndërkombëtare me qëllim miratimin apo të provuarit e vërtetësisë së tekstit të marrëveshjes, apo me qëllimin e shprehjes së pëlqimit të asaj organizate për t'u kufizuar nga dispozitat e një traktati, në qoftë se:

a) ai person zotëron kompetencat e plota të caktuara; ose

b) del nga rrethanat se ishte qëllimi i shteteve dhe i organizatave ndërkombëtare të interesuara për të konsideruar atë person si përfaqësues të organizatës për qëllime të tilla, në përputhje me rregullat e organizatës, pa iu dashur të zotërojë fuqi të plota.

Neni 8

Konfirmimi i mëtejshëm i një akti të kryer pa autorizim

Një akt që ka të bëjë me lidhjen e një traktati të kryer nga një person, i cili nuk mund të konsiderohet sipas nenit 7 si i autorizuar për të përfaqësuar një shtet apo një organizatë ndërkombëtare për atë qëllim, është pa efekte ligjore nëse nuk konfirmohet më pas nga ai shtet apo ajo organizatë.

Neni 9

Miratimi i tekstit

1. Miratimi i tekstit të një traktati bëhet me pëlqimin e të gjitha shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ose sipas rastit nga të gjitha organizatat pjesëmarrëse në hartimin e tij, me përjashtim të rasteve që parashikon paragrafi 2.

2. Miratimi i tekstit të një traktati në një konferencë ndërkombëtare zhvillohet në përputhje me procedurën

që është rënë dakord nga pjesëmarrësit e asaj konference. Nëse, sidoqoftë asnjë marrëveshje nuk është arritur me procedura të tilla, miratimi i tekstit do të bëhet me votën e dy të tretave të anëtarëve të pranishëm derisa e njëjta maxhorancë të vendosë të aplikojë një rregull tjetër.

Neni 10

Vërtetimi i origjinalitetit të tekstit

1. Teksti i një traktati midis një ose më shumë shteteve dhe një ose më shumë organizatave ndërkombëtare është përcaktuar si autentik dhe përfundimtar:

a) nga një procedurë e tillë e parashikuar për tekstin apo për të cilën është rënë dakord nga shtetet dhe organizatat pjesëmarrëse në hartimin e tij; ose

b) mosdhënia rezultat e kësaj procedure, nga nënshkrimi, nënshkrimi *ad referendum* apo siglimi nga përfaqësuesit e atyre shteteve dhe atyre organizatave të tekstit të traktatit apo të aktit final të një konference që përfshin tekstin.

2. Teksti i një traktati midis organizatave ndërkombëtare është përcaktuar si autentik dhe përfundimtar:

a) nga një procedurë e tillë e parashikuar për tekstin apo për të cilën është rënë dakord nga shtetet dhe organizatat pjesëmarrëse në hartimin e tij; ose

b) mosdhënia rezultat e kësaj procedure, nga nënshkrimi, nënshkrimi *ad referendum* apo siglimi nga përfaqësuesit e atyre shteteve dhe atyre organizatave të tekstit të traktatit apo të aktit final të një konference që përfshin tekstin.

Neni 11

Mjetet e shprehjes së pëlqimit për të qenë të detyruara nga dispozitat e një traktati

1. Pëlqimi i një shteti për t'u kufizuar nga dispozitat e një traktati mund të shprehet me nënshkrim, shkëmbim instrumentesh që konstituojnë një traktat, ratifikim, pranim, aprovim apo aderim, ose nga çdo mjet tjetër nëse kështu është rënë dakord.

2. Pëlqimi i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati shprehet me nënshkrim, shkëmbim instrumentesh që konstituojnë një traktat, ratifikim, pranim, aprovim apo aderim, ose nga çdo mjet tjetër nëse kështu është rënë dakord.

Neni 12

Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati e shprehur me nënshkrim

1. Pëlqimi i një shteti apo i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati shprehet nga nënshkrimi i përfaqësuesve të atij shteti apo asaj organizate kur:

a) traktati parashikon që nënshkrimi do të ketë atë efekt;

b) është përcaktuar ndryshe që shtetet negociuese dhe organizatat negociuese apo, sipas rastit, organizatat negociuese kanë rënë dakord që nënshkrimi do të ketë atë efekt; ose

c) qëllimi i shtetit apo organizatës për t'i dhënë atë efekt nënshkrimit buron nga kompetencat e plota të përfaqësuesve të tij ose ishte shprehur gjatë negociatës.

2. Për qëllimet e paragrafit 1:

a) siglimi i një teksti përbën një nënshkrim të një traktati kur është përcaktuar nga shtetet dhe organizatat negociuese ose sipas rastit, ashtu siç kanë rënë dakord organizatat negociuese;

b) nënshkrimi *ad referendum* i një traktati nga përfaqësuesi i një shteti apo një organizate ndërkombëtare, nëse është konfirmuar nga shteti apo organizata e tij, përbën një nënshkrim të plotë të traktatit.

Neni 13

Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati i shprehur nga një shkëmbim i instrumenteve që përbëjnë një traktat

Pëlqimi i shteteve apo i organizatave ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati të përbëra nga instrumente të shkëmbyer midis tyre është shprehur nga ai shkëmbim:

a) instrumentet parashikojnë që shkëmbimi i tyre do të ketë atë efekt; ose

b) është përcaktuar ndryshe që ato shtete dhe ato organizata apo sipas rastit ato organizata kanë rënë dakord që shkëmbimi i instrumenteve do të ketë atë efekt.

Neni 14

Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati e shprehur me ratifikim, akt të konfirmimit formal, pranim apo aprovim

1. Pëlqimi i një shteti për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati shprehet me ratifikim kur:

a) traktati parashikon që një pëlqim i tillë të shprehet me mjete të ratifikimit;

b) është përcaktuar ndryshe se shtetet negociuese dhe organizatat negociuese kanë rënë dakord që kërkohet një ratifikim;

c) përfaqësuesi i shtetit ka nënshkruar traktatin që është subjekt i ratifikimit; ose

d) qëllimi i shtetit për të nënshkruar traktatin subjekt i ratifikimit shfaqet nga kompetencat e plota të përfaqësuesit të tij ose është shprehur gjatë negociatave.

2. Pëlqimi i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është shprehur nga një akt i konfirmimit formal kur:

a) traktati parashikon që një pëlqim i tillë të shprehet me anë të një akti të konfirmimit formal;

b) është përcaktuar ndryshe se shtetet negociuese dhe organizatat negociuese ose sipas rastit organizatat negociuese kanë rënë dakord që të kërkohet një akt i konfirmimit formal;

c) përfaqësuesi i organizatës ka nënshkruar traktatin që është subjekt i një akti të konfirmimit formal; ose

d) qëllimi i organizatës për të nënshkruar traktatin subjekt i një akti formal të konfirmimit shfaqet nga kompetencat e plota të përfaqësuesit të saj ose është shprehur gjatë negociatave.

3. Pëlqimi i një shteti ose i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është shprehur me pranimin apo aprovimin sipas kushteve të ngjashme me ato që aplikohen tek ratifikimi ose sipas rastit tek një akt i konfirmimit formal.

Neni 15

Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati i shprehur me aderimin

Pëlqimi i një shteti ose i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është shprehur me aderim kur:

a) traktati parashikon që një pëlqim i tillë mund të shprehet nga ai shtet ose ajo organizatë nëpërmjet aderimit;

b) është përcaktuar ndryshe se shtetet negociuese dhe organizatat negociuese ose sipas rastit organizatat negociuese kanë rënë dakord që një pëlqim i tillë mund të shprehet nga ai shtet ose nga ajo organizatë nëpërmjet aderimit; ose

c) të gjitha palët kanë rënë më pas dakord që një pëlqim i tillë mund të shprehet nga ai shtet ose ajo organizatë nëpërmjet aderimit.

Neni 16

Shkëmbimi ose depozitimi i instrumenteve të ratifikimit, konfirmimit formal, pranimit, aprovimit ose aderimit

1. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, instrumentet e ratifikimit, instrumente që lidhen me një akt të konfirmimit formal ose instrumente të pranimit, aprovimit apo aderimit përcaktojnë pëlqimin e një shteti ose të një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati midis një ose më shumë shteteve dhe një ose më shumë organizatave ndërkombëtare në:

a) shkëmbimet e tyre midis shteteve kontraktuese dhe organizatave kontraktuese; ose

b) depozitës së tyre me depozitarin; ose

c) njoftimin ndaj shteteve kontraktuese dhe organizatave kontraktuese ose ndaj depozitarit, nëse kështu është rënë dakord.

2. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, instrumentet që lidhen me një akt të konfirmimit formal apo me instrumente të pranimit, aprovimit apo aderimit përcaktojnë pëlqimin e një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati midis organizatave ndërkombëtare, përsa i përket:

a)shkëmbimeve të tyre midis organizatave kontraktuese;

b) depozitës së tyre me depozitarin; ose

c) njoftimin ndaj organizatave kontraktuese apo ndaj depozitarit, nëse kështu është rënë dakord.

Neni 17

Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një pjese të një traktati dhe zgjedhja e dispozitave të ndryshme

1. Pa cenuar nenet 19 deri në 23, pëlqimi i një shteti apo i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga pjesë të një traktati është efikase vetëm nëse traktati e ka lejuar kështu, ose nëse shtetet kontraktuese dhe organizatat kontraktuese ose sipas rastit organizatat kontraktuese kanë rënë dakord kështu.

2. Pëlqimi i një shteti apo i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati, i cili lejon një zgjedhje midis dispozitave të ndryshme, është efikase vetëm nëse është bërë e qartë se me cilën prej dispozitave është i lidhur pëlqimi.

Neni 18

Detyrimi për të mos humbur objektin dhe qëllimin e një traktati para hyrjes së tij në fuqi

Një shtet apo një organizatë ndërkombëtare është i detyruar t'u shmanget akteve që do të humbitnin objektin dhe qëllimin e një traktati nëse:

a) ai shtet apo ajo organizatë ka nënshkruar traktatin apo ka shkëmbyer instrumente që përbëjnë traktatin subjekt i ratifikimit, aktin e konfirmimit formal, pranimin apo aprovimin, derisa ai shtet apo ajo organizatë do ta ketë bërë qëllimin e saj të qartë për të mos u bërë pjesë e traktatit; ose

b) ai shtet apo ajo organizatë ka shprehur pëlqimin e tij për t'u kufizuar nga traktati, duke pritur hyrjen në fuqi të traktatit dhe me kusht që kjo hyrje në fuqi të mos jetë vonuar shumë.

SEKSIONI 2. REZERVAT

Neni 19

Formulimi i rezervave

Një shtet ose një organizatë ndërkombëtare mund të formulojë një rezervë kur nënshkruan, ratifikon, konfirmon formalisht, pranon, aprovon apo aderon në një traktat, përsa kohë që:

a) rezerva nuk është ndaluar nga traktati;

b) traktati nuk parashikon që vetëm rezerva të specifikuara, të cilat nuk përfshijnë rezervën të cilën po trajtojmë, mund të bëhen; ose

c) në çështje që nuk parashikohen në nënparagrafët "a" dhe "b", rezerva nuk përputhet me objektin dhe qëllimin e traktatit.

Neni 20
Pranimi dhe kundërshtimi ndaj rezervës

1. Një rezervë e autorizuar shprehimisht nga një traktat nuk kërkon ndonjë pranim të mëtejshëm nga shtetet kontraktuese dhe organizatat kontraktuese ose sipas rastit nga organizatat kontraktuese, nëse traktati nuk e parashikon kështu.

2. Kur nga numri i kufizuar i shteteve negociuese dhe organizatave negociuese ose sipas rastit i organizatave negociuese del dhe objekti dhe qëllimi i një traktati dhe që aplikimi i plotë i një traktati midis të gjitha palëve është një kusht i rëndësishëm i pëlqimit të secilës për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati, një rezervë kërkon pranim nga të gjitha palët.

3. Kur një traktat është një instrument përbërës i një organizate ndërkombëtare dhe nëse nuk parashikohet ndryshe, një rezerve i nevojitet pranimi nga organet kompetente të asaj organizate.

4. Në raste që nuk parashikohen në paragrafët e mësipërm dhe nëse traktati nuk parashikon ndryshe:

a) pranimi i një rezerve nga një shtet kontraktues ose nga një organizatë kontraktuese e bën shtetin apo organizatën ndërkombëtare që ka rezerva një palë në traktat në lidhje me shtetin dhe organizatën pranuese nëse ose kur traktati është në fuqi për shtetin apo organizatën që ka rezerva dhe për shtetin apo organizatën pranuese;

b) një kundërshtim i rezervës nga një shtet kontraktues ose nga një organizatë kontraktuese nuk pengon hyrjen në fuqi të traktatit si midis shtetit kundërshtues apo organizatës ndërkombëtare dhe shtetit apo organizatën që ka rezerva derisa nuk është shprehur përfundimisht një qëllim i kundërt nga shtetet apo organizatat kundërshtuese;

c) një akt që mban një rezervë dhe që shpreh pëlqimin e një shteti apo të një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati, është efikas sapo të paktën një shtet kontraktues ose një organizatë kontraktuese të ketë pranuar rezervën.

5. Për qëllimet e paragrafit 2 dhe 4, dhe nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, një rezervë konsiderohet që është pranuar nga një shtet apo një organizatë ndërkombëtare nëse ajo nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim ndaj rezervës deri në fund të një periudhe dymbëdhjetëmujore pasi ka marrë njoftim për rezervën ose nga data në të cilën është shprehur pëlqimi i saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati, cilido qoftë i fundit.

Neni 21
Efektet ligjore të rezervave dhe të kundërshtimeve ndaj rezervave

1. Një rezervë e përcaktuar në lidhje me një palë tjetër në përputhje me nenet 19, 20 dhe 23:

a) modifikon dispozitat e traktatit me të cilat lidhet rezerva deri në masën e rezervës, për shtetin apo organizatën ndërkombëtare që ka rezerva në lidhje me palën tjetër; dhe

b) modifikon ato dispozita në të njëjtën masë me ato të palës tjetër në lidhje me shtetin apo organizatën ndërkombëtare që ka rezerva.

2. Rezerva nuk modifikon dispozitat e traktatit për palët e tjera në traktat ndërmjet tyre.

3. Kur një shtet apo një organizatë ndërkombëtare kundërshtues ndaj rezervës nuk kanë kundërshtuar hyrjen në fuqi të traktatit midis vetes së tyre dhe shtetit apo organizatës që ka rezerva, dispozitat me të cilat rezerva lidhet nuk zbatohen midis shtetit apo organizatës që ka rezerva dhe shtetit apo organizatës kundërshtuese deri në masën e rezervës.

Neni 22
Tërheqja e rezervave dhe e kundërshtimeve ndaj rezervave

1. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, një rezervë mund të tërhiqet në çdo kohë dhe nuk nevojitet pëlqimi i një shteti apo i një organizate ndërkombëtare që ka pranuar rezervën për tërheqjen e saj.

2. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, një kundërshtim ndaj rezervës mund të tërhiqet në çdo kohë.

3. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe apo nëse nuk është rënë dakord ndryshe:

a) tërheqja e një rezerve hyn në fuqi në lidhje me një shtet apo organizatë kontraktuese vetëm kur është marrë lajmërim për të nga një shtet apo nga ajo organizatë;

b) tërheqja e një kundërshtimi ndaj rezervës hyn në fuqi vetëm kur është marrë njoftimi nga shteti apo organizata ndërkombëtare e cila ka formuluar rezervën.

Neni 23
Procedurat që lidhen me rezervat

1. Një rezervë, një pranim i shprehur i një rezerve duhet të formulohet me shkrim dhe t'i komunikohet shteteve dhe organizatave kontraktuese dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që kanë të drejtën të jenë palë në traktat.

2. Pasi është formuluar kur nënshkruhet traktati subjekt i ratifikimit, akti i konfirmimit formal, pranimi apo aprovimi, një rezervë duhet të konfirmohet zyrtarisht nga shteti apo organizata ndërkombëtare që ka rezerva kur ka shprehur pëlqimin e saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati. Në raste të tilla rezerva do të konsiderohet sikur është bërë në datën e konfirmimit të saj.

3. Një pranim i shprehur apo një kundërshtim ndaj rezervës, i bërë më parë se konfirmimi i rezervës, nuk kërkon një konfirmim.

4. Tërheqja e një rezerve apo e një kundërshtimi ndaj rezervës duhet të formulohet me shkrim.

SEKSIONI 3. HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI I PËRKOHSHËM I TRAKTATEVE

Neni 24
Hyrja në fuqi

1. Një traktat hyn në fuqi në një mënyrë të tillë dhe në një datë të tillë siç mund të jetë parashikuar apo si mund të bien dakord shtetet dhe organizatat negociuese apo, sipas rastit, organizatat negociuese.

2. Mosrealizimi i ndonjë dispozite apo marrëveshjeje të tillë bën që një traktat të hyjë në fuqi sapo të jetë dhënë pëlqimi për të qenë të detyruara nga dispozitat e traktatit për të gjitha shtetet dhe organizatat negociuese ose, sipas rastit, për të gjitha organizatat negociuese.

3. Kur pëlqimi i një shteti apo i një organizate ndërkombëtare për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është dhënë në një datë pas hyrjes në fuqi të traktatit, ky i fundit hyn në fuqi në atë ditë për atë shtet apo atë organizatë, nëse traktati nuk e parashikon ndryshe.

4. Dispozitat e një traktati që rregullojnë vërtetësinë e tekstit të tij, dhënien e pëlqimit për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati, mënyrën apo datën e hyrjes së tij në fuqi, rezervat, funksionet e depozitarit dhe çështje të tjera që dalin detyrimisht para hyrjes në fuqi të traktatit, zbatohen nga koha e miratimit të tekstit të tij.

Neni 25
Zbatimi i përkohshëm

1. Një traktat ose një pjesë e një traktati zbatohet përkohësisht duke pritur hyrjen e tij në fuqi nëse:

a) vetë traktati e parashikon kështu; ose

b) shtetet negociuese dhe organizatat negociuese ose, sipas rastit, organizatat negociuese kanë rënë dakord kështu në ndonjë mënyrë tjetër.

2. Traktati nuk e parashikon ndryshe apo shtetet dhe organizatat negociuese ose, sipas rastit, nëse organizatat negociuese nuk kanë rënë dakord ndryshe, aplikimi i përkohshëm i një traktati apo i një pjese të tij në lidhje me shtetin apo organizatën ndërkombëtare do të përfundojë nëse ai shtet ose ajo organizatë njofton shtetet dhe organizatat ku traktati po zbatohet përkohësisht për qëllimin e tij për të mos u bërë palë në traktat.

PJESA III
RESPEKTIMI, ZBATIMI DHE INTERPRETIMI I TRAKTATEVE
SEKSIONI 1. RESPEKTIMI I TRAKTATEVE

Neni 26
Pacta sunt servanda
Marrëveshjet duhet të përmbushen

Çdo traktat që është në fuqi është detyrues për palët e tij dhe duhet të zbatohet prej tyre në mirëbesim.

Neni 27
E drejta e brendshme e shteteve, rregullat e organizatave ndërkombëtare dhe respektimi i traktateve

1. Shteti palë në një traktat mund të mos i përdorë dispozitat e të drejtës së brendshme si justifikim për dështimin e tij në përmbushjen e traktatit.

2. Një organizatë ndërkombëtare, palë e një marrëveshjeje, mund të mos i përdorë rregullat e organizatës si justifikim për dështimin e saj në përmbushjen e traktatit.

3. Rregullat e përfshira në paragrafët e mëparshëm nuk cenojnë nenin 46.

SEKSIONI 2. ZBATIMI I TRAKTATEVE

Neni 28
Fuqia joprapavepruese e traktateve

Nëse nuk shfaqet apo nuk është përcaktuar ndryshe një qëllim tjetër nga traktati, dispozitat e tij nuk e detyrojnë një palë ndaj ndonjë akti apo fakti që ka ndodhur ose ndonjë situatë cila ka pushuar së ekzistuari para datës së hyrjes në fuqi të traktatit dhe që ka lidhje me atë palë.

Neni 29
Shtrirja territoriale e traktateve

Nëse nuk shfaqet ndonjë qëllim tjetër nga traktati apo nëse nuk është përcaktuar ndryshe, një traktat midis një ose më shumë shteteve dhe një ose më shumë organizatave ndërkombëtare është detyrues për çdo shtet që është palë në të gjithë territorin e tij.

Neni 30
Zbatimi i traktateve pasuese për të njëjtën çështje

1. Të drejtat dhe detyrimet e shteteve dhe të organizatave ndërkombëtare, palë në traktatet pasuese në lidhje me të njëjtën çështje, do të përcaktohen në përputhje me paragrafët e mposhtëm.

2. Kur një traktat specifikon që është subjekt apo që nuk duhet të konsiderohet si i papajtueshëm, me një traktat më të hershëm apo më të vonë, dispozitat e atij traktati do të kenë epërsi.

3. Kur të gjitha palët e një traktati më të hershëm janë gjithashtu palë të traktatit më të vonë, por traktati më i hershëm nuk ka përfunduar apo të jetë pezulluar sipas nenit 59, traktati më i hershëm zbatohet në atë masë që dispozitat e tij të jenë në përputhje me ato të traktatit të mëvonshëm.

4. Kur palët në traktatin më të fundit nuk përfshijnë të gjitha palët e traktatit më të hershëm:

a) si midis dy palëve, ku secila prej tyre është palë në të dyja traktatet, i njëjti rregull zbatohet si në paragrafin 3;

b) si midis një pale pjesë e të dy traktateve dhe një pale pjesë e vetëm njërit prej traktateve, traktati në të cilin të dyja janë palë rregullon të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.

5. Paragrafi 4 nuk cenon nenin 41, apo ndonjë çështje mbi përfundimin apo pezullimin e funksionimit të traktatit sipas nenit 60 apo ndonjë çështje përgjegjësie që mund të dalë për një shtet apo për një organizatë ndërkombëtare nga lidhja apo zbatimi i një traktati dispozitat e të cilit janë të papajtueshme me detyrimet e tij ndaj një shteti apo një organizate sipas një traktati tjetër.

6. Paragrafët e mëparshëm nuk e cenojnë faktin që në rast të një konflikti midis detyrimeve sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe detyrimeve të lindura nga një traktat, detyrimet sipas Kartës do të kenë epërsi.

SEKSIONI 3. INTERPRETIMI I TRAKTATEVE

Neni 31
Rregulli i përgjithshëm i interpretimit

1. Një traktat do të interpretohet në mirëbesim në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u jepet termave të traktatit në kontekstin e tyre dhe në dritën e objektit dhe qëllimit të tij.

2. Konteksti për qëllimin e interpretimit të një traktati do të përmbajë, përveç tekstit, edhe preambulën dhe shtojcat:

a) çdo marrëveshje e lidhur me traktatin, e cila ishte bërë midis të gjitha palëve në lidhje me përfundimin e traktatit;

b) çdo instrument që ishte bërë nga një apo më shumë palë në lidhje me përfundimin e traktatit dhe e pranuar nga palët e tjera si një instrument i lidhur me traktatin.

3. Do të merren parasysh, së bashku me kontekstin:

a) çdo marrëveshje e mëtejshme midis palëve që ka lidhje me interpretimin e një traktati apo zbatimin e dispozitave të tij;

b) çdo praktikë pasuese në zbatimin e traktatit e cila përcakton marrëveshjen e palëve lidhur me interpretimin e saj;

c) ndonjë nga rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në marrëdhëniet midis palëve.

4. Një kuptim i veçantë do t'i jepet një termi nëse përcaktohet se kështu ishte menduar nga palët.

Neni 32
Mjetet plotësuese të interpretimit

Ndihmë mund t'u kërkohet mjeteve plotësuese të interpretimit, duke përfshirë punën përgatitore të traktatit dhe rrethanat e lidhjes së tij, me qëllim për të konfirmuar kuptimin që vjen nga zbatimi i nenit 31, ose për të përcaktuar kuptimin kur interpretimi sipas nenit 31:

a) e lë kuptimin të paqartë ose të errët; ose

b) çon në një rezultat i cili është haptazi absurd ose i paarsyeshëm.

Neni 33
Interpretimi i traktateve i vërtetuar në dy apo më shumë gjuhë

1. Kur një traktat është vërtetuar në dy apo më shumë gjuhë, teksti është njësoj autoritar në çdo gjuhë, nëse traktati nuk e parashikon apo nëse palët nuk bien dakord, në rast mosmarrëveshjeje një tekst i caktuar do të ketë epërsi.

2. Një version i traktatit në një gjuhë ndryshe nga ajo gjuhë në të cilën teksti ishte vërtetuar, do të konsiderohet një tekst autentik vetëm nëse traktati e parashikon apo nëse palët bien dakord kështu.

3. Termat e një traktati prezumohen të kenë të njëjtin kuptim në çdo tekst autentik.

4. Me përjashtim të rasteve kur një tekst i caktuar prevalon në përputhje me paragrafin 1, kur një krahasim i teksteve autentike nxjerr në pah një ndryshim të kuptimit të cilin zbatimi i neneve 31 dhe 32 nuk e heq, atëherë do të miratohet kuptimi që i përputhet më mirë tekstit, në lidhje me objektin dhe qëllimin e traktatit.

SEKSIONI 4. TRAKTATET DHE SHTETET OSE ORGANIZATAT E TRETA

Neni 34
Rregulli i përgjithshëm në lidhje me shtetet e treta dhe organizatat e treta

Një traktat nuk krijon as detyrime, dhe as të drejta për një shtet të tretë apo një organizatë të tretë pa pëlqimin e atij shteti apo asaj organizate.

Neni 35
Traktatet që parashikojnë detyrimet për shtetet e treta ose organizatat e treta

Një detyrim del për një shtet apo një organizatë të tretë nga një dispozitë e një traktati nëse palët në traktat synojnë që dispozita të jetë mjet i përcaktimit të

detyrimit dhe shteti apo organizata e tretë pranojnë shprehimisht atë detyrim me shkrim. Pranimi nga organizata e tretë i një detyrimi të tillë do të rregullohet nga rregullat e asaj organizate.

Neni 36

Traktatet që parashikojnë të drejtat për shtetet e treta ose organizatat e treta

1. Një e drejtë lind për një shtet të tretë nga një dispozitë e një traktati nëse palët në traktat synojnë që dispozita t'ia japë atë të drejtë si shtetit të tretë, ashtu edhe një grupi shtetesh të cilëve iu përket, apo të gjitha shteteve dhe shtetit të tretë që ka dhënë pëlqimin me to. Pëlqimi i tij do të merret si i mirëqenë nëse traktati nuk e parashikon ndryshe.

2. Një e drejtë lind për një organizatë të tretë nga një dispozitë e një traktati nëse palët në traktat synojnë që dispozita t'ia japë atë të drejtë si organizatës së tretë, ashtu edhe një grupi organizatash ndërkombëtare të cilave iu përket, apo të gjitha organizatave dhe organizatës së tretë që ka dhënë pëlqimin me to. Pëlqimi i saj do të rregullohet nga rregullat e organizatës.

3. Një shtet apo një organizatë ndërkombëtare, që ushtron një të drejtë në përputhje me paragrafin 1 ose 2, do të pajtohen me kushtet për ushtrimin e saj të parashikuar në traktat apo të përcaktuar konform traktatit.

Neni 37

Revokimi apo modifikimi i detyrimeve dhe i të drejtave të shteteve të treta apo organizatave të treta

1. Kur një detyrim ka dalë për një shtet të tretë apo një organizatë të tretë në përputhje me nenin 35, detyrimi mund të revokohet ose modifikohet vetëm me pëlqimin e palëve në traktat dhe të shteteve dhe organizatave të treta, nëse nuk është përcaktuar që ata kanë rënë dakord ndryshe.

2. Kur një e drejtë ka lindur për një shtet apo organizatë të tretë në përputhje me nenin 36, e drejta mund të mos revokohet apo modifikohet nga palët nëse është përcaktuar që e drejta synonte të mos ishte e revokueshme apo subjekt i modifikimit të tretë apo organizatës së tretë.

3. Pëlqimi i një organizate ndërkombëtare, palë në traktat, apo e një organizate të tretë, siç është parashikuar në paragrafët e mëparshëm, do të rregullohet nga rregullat e asaj organizate.

Neni 38

Rregullat e traktatit që bëhen detyruese për shtetet e treta ose organizatat e treta përmes rregullave zakonore ndërkombëtare

Asgjë në nenet 34 deri 37 nuk e pengon një rregull të vendosur në një traktat që të bëhet i detyrueshëm për një shtet të tretë apo organizatë të tretë si rregull zakonor i së drejtës ndërkombëtare e njohur si e tillë.

PJESA IV

AMENDAMENTET DHE MODIFIKIMET E TRAKTATEVE

Neni 39

Rregulli i përgjithshëm që lidhet me ndryshimet e traktateve

1. Një traktat mund të ndryshohet me marrëveshje ndërmjet palëve. Rregullat e vendosura në pjesën II zbatohen në një marrëveshje të tillë, përveç rasteve kur traktati mund ta parashikojë ndryshe.

2. Pëlqimi i një organizate ndërkombëtare për një marrëveshje të parashikuar nga paragrafi 1 do të rregullohet nga rregullat e asaj organizate.

Neni 40

Ndryshimet e traktateve shumëpalëshe

1. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, ndryshimi i traktateve shumëpalëshe do të rregullohet nga paragrafët në vazhdim.

2. Çdo propozim për të amenduar një traktat shumëpalësh midis të gjitha palëve duhet t'i bëhet me dije të gjitha shteteve kontraktuese edhe organizatave kontraktuese, ku secila prej tyre do të ketë të drejtën për të marrë pjesë në të:

a) vendimi për veprimet që do ndërmerren në lidhje me një propozim të tillë;

b) bisedimet dhe përfundimi i çdo marrëveshjeje për ndryshimin e traktatit.

3. Çdo shteti apo organizate ndërkombëtare që ka të drejtën për të qenë palë e traktatit gjithashtu do t'i jepet e drejta për të qenë palë e marrëveshjes të ndryshuar.

4. Marrëveshja e ndryshuar nuk detyron asnjë shtet apo organizatë ndërkombëtare tashmë palë e traktatit të bëhet palë në marrëveshjet e ndryshuara; neni 30, paragrafi 4 (b), zbatohet në lidhje me shtete të tilla apo organizata.

5. Çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare, e cila bëhet palë në traktat pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes të ndryshuar, nëse nuk shpreh ndonjë qëllim të ndryshëm nga ai shtet apo ajo organizatë:

a) do të konsiderohet si një palë e traktatit të ndryshuar; dhe

b) do të konsiderohet si një palë e traktatit të pandryshuar në lidhje me çdo palë në traktat të pakufizuar nga marrëveshja e ndryshuar.

Neni 41

Marrëveshje për të modifikuar traktatet shumëpalëshe midis vetëm disa palëve

1. Dy apo më shumë nga palët në një traktat shumëpalësh mund të arrijnë një marrëveshje për të modifikuar traktatin midis vetë njëra-tjetrës në qoftë se:

a) mundësia e një modifikimi të tillë parashikohet nga traktati; ose

b) modifikimi në fjalë nuk ndalohet nga traktati dhe:

i) nuk ndikon në gëzimin e të drejtave të palëve të tjera sipas traktatit apo performancës së detyrimeve të tyre;

ii) nuk lidhet me një dispozitë, tërheqja nga e cila është e papajtueshme me realizimin efektiv të objektit dhe qëllimit të traktatit si një e tërë.

2. Nëse në ndonjë rast që rregullohet nga paragrafi 1(a) traktati nuk e parashikon ndryshe, palët në fjalë do të njoftojnë palët e tjera për qëllimin e tyre për të arritur marrëveshjen dhe për modifikimin e traktatit ashtu si parashikohet.

PJESA V

PAVLEFSHMËRIA, PËRFUNDIMI DHE PEZULLIMI I FUNKSIONIMIT TË TRAKTATIT

SEKSIONI 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 42

Vlefshmëria dhe vazhdimësia e fuqisë së traktateve

1. Vlefshmëria e një traktati apo e pëlqimit të një shteti apo një organizate ndërkombëtare për t'u kufizuar nga një traktat mund të vërtetohet vetëm nëpërmjet zbatimit të kësaj Konvente.

2. Përfundimi i një traktati, prishja e marrëveshjes apo tërheqja e një pale, mund të ndodhë vetëm si pasojë e zbatimit të dispozitave të traktatit apo të kësaj Konvente. I njëjti rregull zbatohet edhe ndaj pezullimit të veprimit të një traktati.

Neni 43

Detyrimet e imponuara nga e drejta ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga një traktat

Pavlefshmëria, përfundimi apo prishja e marrëveshjes së një traktati, tërheqja e një pale nga traktati ose pezullimi i funksionimit të tij, si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente apo e dispozitave të traktatit, nuk do të dëmtojë detyrën e çdo shteti apo të çdo organizate ndërkombëtare për të përmbushur çdo detyrim të mishëruar në traktat ndaj të cilit ai shtet apo ajo organizatë do të jetë subjekt sipas të drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga traktati.

Neni 44

Ndashmëria e dispozitave të traktatit

1. E drejta e një pale, e parashikuar në traktat apo që lind nga neni 56, për të prishur marrëveshjen, të tërhiqet apo të pezullojë funksionimin e traktatit mund të ushtrohet vetëm në lidhje me të gjithë traktatin nëse traktati nuk e parashikon ndryshe apo nëse palët nuk bien dakord ndryshe.

2. Baza për pavlefshmërinë, përfundimin, tërheqjen apo pezullimin e pasjes fuqi të një traktati, të njohura në këtë Konventë, mund të thirren vetëm në lidhje me të gjithë traktatin, përveç rasteve të parashikuara në paragrafët e mposhtëm apo në nenin 60.

3. Nëse baza lidhet vetëm me klauzola të veçanta, ajo mund të thirret vetëm në lidhje me ato klauzola, ku:

a) klauzolat e përmendura janë të ndashme nga pjesa e mbetur e traktatit në lidhje me aplikimine tyre;

b) nga traktati del se apo si mund të jetë përcaktuar ndryshe se pranimi i atyre klauzolave nuk ishte një bazë e rëndësishme e pëlqimit të palës apo palëve të tjera për t'u kufizuar nga një traktat si një i tërë; dhe

c) performanca e vazhduar e pjesës së mbetur të traktatit nuk do të ishte e padrejtë.

4. Në raste që rregullohen sipas neneve 49 dhe 50, shteti apo organizata ndërkombëtare me të drejtën për të përdorur mashtrimin apo korrupsionin mund të veprojë kështu në lidhje me të gjithë traktatin apo subjekt i paragrafit 3, vetëm për klauzola të veçanta.

5. Në rastet që rregullohen me nenet 51, 52 dhe 53, nuk lejohet asnjë ndarje e dispozitave të traktatit.

Neni 45

Humbja e një të drejte për të kërkuar një bazë për pavlefshmërinë, përfundimin, tërheqjen apo pezullimin e fuqisë vepruese të një traktati

1. Një shtet nuk mund më të kërkojë një bazë për pavlefshmëri, përfundim, tërheqje apo pezullim të fuqisë së një traktati sipas neneve 46 deri në 50 apo nenet 60 dhe 62 në qoftë se, pasi bëhet i ndërgjegjshëm për faktet:

a) ai do të ketë rënë shprehimisht dakord që traktati është i vlefshëm apo mbetet fuqi ose vazhdon funksionimin sipas rastit; ose

b) duhet që, për shkak të sjelljes së tij, të konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për vlefshmërinë e traktatit, për mbajtjen e tij në fuqi apo në funksionim sipas rastit.

2. Një organizatë ndërkombëtare nuk mund më të kërkojë një bazë për pavlefshmëri, përfundim, tërheqje apo pezullim të fuqisë së një traktati sipas neneve 46 deri në 50 apo nenet 60 dhe 62 në qoftë se, pasi bëhet i ndërgjegjshëm për faktet:

a) ajo do të ketë rënë shprehimisht dakord që traktati është i vlefshëm, mbetet fuqi ose vazhdon funksionimin sipas rastit; ose

b) duhet që, për shkak të sjelljes së organit kompetent, të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar atë bazë.

SEKSIONI 2. PAVLEFSHMËRIA E TRAKTATIT

Neni 46

Dispozitat e të drejtës së brendshme të një shteti dhe rregullat e organizatës ndërkombëtare që lidhen me kompetencën për të lidhur traktate

1. Një shtet nuk mund të përdorë faktin që pëlqimi i tij për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është shprehur duke cenuar një dispozitë të së drejtës së tij të

brendshme në lidhje me kompetencën për të lidhur traktate duke bërë të pavlefshëm pëlqimin e tij nëse ai cenim nuk ishte i qartë dhe nuk lidhet me një rregull të së drejtës së brendshme të një rëndësie të madhe.

2. Një organizatë ndërkombëtare nuk mund të përdorë faktin që pëlqimi i saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati është shprehur duke cenuar rregullat e organizatës në lidhje me kompetencën për të përfunduar traktatet duke bërë të pavlefshëm pëlqimin e tij nëse ai cenim nuk ishte i qartë dhe nuk lidhet me një rregull të së drejtës së brendshme të një rëndësie kryesore.

3. Një cenim është i qartë nëse do të jetë objektivisht i dallueshëm për çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare që e drejton veten në këtë çështje në lidhje me praktikën normale të shteteve dhe aty ku është e nevojshme, edhe të organizatave ndërkombëtare dhe në mirëbesim.

Neni 47

Kufizime specifike mbi autoritetin për të shprehur pëlqimin e një shteti apo një organizate ndërkombëtare

Nëse autoriteti i një përfaqësuesi për të shprehur pëlqimin e një shteti apo të një organizate ndërkombëtare për të qenë e detyruar nga dispozitat e një traktati të veçantë është bërë subjekt i një kufizimi specifik, mospranimi i tij për të respektuar atë kufizim mund të mos konsiderohet që bën të pavlefshëm pëlqimin e shprehur nga ai nëse kufizimi nuk i bëhet i ditur shteteve negociuese dhe organizatave negociuese para shprehjes së pëlqimit të tyre.

Neni 48

Gabimi

1. Një shtet apo një organizatë ndërkombëtare mund ta mendojë një gabim në një traktat se bën të pavlefshëm pëlqimin e tij për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati nga traktati nëse gabimi lidhet me një fakt apo situatë e cila supozohej nga ai shtet apo ajo organizatë se ekzistonte në kohën kur traktati ishte lidhur dhe formonte një bazë kryesore të pëlqimit të atij shteti për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati.

2. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet nëse shteti apo organizata ndërkombëtare në fjalë ka kontribuar me sjelljen e tij/saj te gabimi apo nëse rrethanat ishin të tilla sa ta vendosnin atë shtet apo atë organizatë në dijeni të një gabimi të mundshëm.

3. Një gabim i lidhur vetëm me mënyrën e të shprehurit të tekstit të traktatit nuk prek vlefshmërinë e tij; atëherë zbatohet neni 80.

Neni 49

Mashtrimi

Një shtet apo një organizatë ndërkombëtare e shtyrë për të lidhur një traktat nga sjellja mashtruese e një shteti negociues apo e një organizate negociuese mund ta përdorë mashtrimin që ka bërë të mundur pavlefshmërinë e pëlqimit të tij/saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati.

Neni 50

Korrupsioni i një përfaqësuesi të një shteti apo i një organizate ndërkombëtare

Një shtet apo një organizatë ndërkombëtare, shprehja e vullnetit të të cilëve për t'u detyruar nga dispozitat e një traktat, është siguruar përmes korrupsionit të përfaqësuesit të tij/saj në mënyrë direkte ose indirekte nga një shtet negociues apo organizatë negociuese, mund të pretendojë se ky korrupsion e bën të pavlefshëm pëlqimin e tij/saj për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati.

Neni 51

Detyrimi i një përfaqësuesi të një shteti apo i një organizate ndërkombëtare

Shprehja nga një shtet apo një organizatë ndërkombëtare e pëlqimit për t'u kufizuar nga një traktat, e cila është siguruar nga detyrimi që i është bërë përfaqësuesit të atij shteti apo të asaj organizate nëpërmjet akteve apo kërcënimeve të drejtuara kundër tij, do të jenë pa ndonjë efekt ligjor.

Neni 52

Detyrimi i një shteti apo një organizate ndërkombëtare nëpërmjet kërcënimit apo përdorimit të forcës

Një traktat është i pavlefshëm në qoftë se lidhja e tij është bërë nëpërmjet kërcënimit apo përdorimit të forcës në cenim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare të mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 53

Traktatet që bien ndesh me një normë të pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme (*jus cogens*)

Një traktat është i pavlefshëm nëse në kohën e lidhjes të tij ai bie ndesh me një normë të pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme. Për qëllime të kësaj Konvente, një normë e pakundërshtueshme e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme është një normë e pranuar dhe e njohur nga komuniteti ndërkombëtar i shteteve si një normë nga e cila nuk lejohet asnjë tërheqje e pjesshme dhe e cila mund të modifikohet vetëm nga një normë pasuese e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme që ka të njëjtin karakter.

SEKSIONI 3. PËRFUNDIMI DHE PEZULLIMI I FUQISË VEPRUESE TË TRAKTATEVE

Neni 54

Përfundimi apo tërheqja nga traktati sipas dispozitave të tij ose me pëlqim të palëve

Përfundimi i një traktati apo tërheqja e një pale mund të ndodhë:

a) në përputhje me dispozitat e traktatit; ose

b) në çdo kohë, me pëlqimin e të gjitha palëve pas konsultimit me shtetet kontraktuese dhe organizatave kontraktuese.

Neni 55

Reduktimi i palëve në një traktat shumëpalësh nën numrin që nevojitet për hyrjen e tij në fuqi

Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe, një traktat shumëpalësh nuk përfundon vetëm për faktin që numri i palëve bie nën numrin e nevojshëm për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 56

Prishja e marrëveshjes ose tërheqja nga një traktat që nuk përmban dispozita në lidhje me përfundimin, prishjen e marrëveshjes apo tërheqjen

1. Një traktat, i cili nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me përfundimin e tij dhe i cili nuk siguron prishjen e marrëveshjes apo tërheqjen, nuk është subjekt i prishjes së marrëveshjes apo tërheqjes në qoftë se:

a) nuk është vendosur që palët synonin të pranonin mundësinë e prishjes së marrëveshjes apo tërheqjes; ose

b) vetëm nëse një e drejtë për prishjen e marrëveshjes apo tërheqjen të jetë lënë të kuptohet nga natyra e traktatit.

2. Një palë duhet të njoftojë për qëllimin e saj për të prishur marrëveshjen apo për t'u tërhequr nga një traktat jo më pak se dymbëdhjetë muaj para sipas paragrafit 1.

Neni 57

Pezullimi i veprimit të një traktati sipas dispozitave të tij ose me pëlqimin e palëve

Fuqia vepruese e një traktati në lidhje me të gjitha palët apo me një palë të veçantë mund të pezullohet:

a) në përputhje me dispozitat e traktatit; ose

b) në çdo kohë, me pëlqimin e të gjitha palëve pas konsultimit me shtetet dhe organizatat kontraktuese.

Neni 58

Pezullimi i veprimit të një traktati shumëpalësh me marrëveshje midis vetëm disa prej palëve

1. Dy apo më shumë palë në një marrëveshje shumëpalëshe mund të lidhin një marrëveshje për të pezulluar fuqinë vepruese të dispozitave të traktatit, përkohësisht dhe midis njëra-tjetrës në qoftë se:

a) mundësia e një pezullimi të tillë parashikohet nga traktati; ose

b) pezullimi në fjalë nuk është i ndaluar nga traktati dhe:

i) nuk ndikon në gëzimin e të drejtave nga palët e tjera sipas traktatit apo performancës së detyrimeve të tyre;

ii) nuk është i papajtueshëm me objektin dhe qëllimin e traktatit.

2. Nëse në ndonjë rast të parashikuar nga paragrafi 1 (a), traktati nuk e parashikon ndryshe, palët në fjalë do të njoftojnë palët e tjera për qëllimin e tyre për të arritur një marrëveshje dhe atyre dispozitave të traktatit, fuqinë vepruese të të cilave ato synojnë të pezullojnë.

Neni 59

Përfundimi apo pezullimi i fuqisë vepruese të traktatit që nënkuptohet nga lidhja e një traktati të mëvonshëm

1. Një traktat do të konsiderohet si i përfunduar nëse të gjitha palët në të lidhin një traktat të mëvonshëm që lidhet me të njëjtën temë dhe:

a) nga traktati i mëvonshëm del që apo është përcaktuar ndryshe që palët synonin se çështja do të rregullohej nga ai traktat; ose

b) dispozitat e traktatit të mëvonshëm janë të papajtueshme me ato të traktatit të mëparshëm që të dy traktatet të jenë në gjendje të zbatohen në të njëjtën kohë.

2. Traktati i mëparshëm do të konsiderohet i pezulluar në fuqi vepruese nëse del nga traktati i mëvonshëm apo është përcaktuar ndryshe që ky ishte qëllimi i palëve.

Neni 60

Përfundimi apo pezullimi i fuqisë vepruese të traktatit si pasojë e shkeljes së tij

1. Një shkelje serioze e një traktati dypalësh nga njëra palë i jep të drejtën palës tjetër ta përdorë shkeljen si bazë për përfundimin e traktatit apo pezullimin e fuqisë së tij vepruese në tërësi apo në pjesë.

2. Një shkelje serioze e një traktati shumëpalësh nga njëra prej palëve i jep të drejtën:

a) palëve të tjera që me marrëveshje unanime të pezullojnë fuqinë vepruese të traktatit në tërësi apo në pjesë apo t'i japin fund atij gjithashtu:

i) në marrëdhënie midis njëra-tjetrës dhe shtetit që nuk ka përmbushur detyrimet apo organizatës ndërkombëtare;

ii) midis të gjitha palëve;

b) një pale veçanërisht të prekur nga shkelja për ta përdorur atë si bazë për pezullimin e fuqisë vepruese të traktatit në tërësi apo pjesërisht në marrëdhëniet midis vetes dhe shtetit apo organizatës ndërkombëtare që nuk ka përmbushur detyrimet;

c) çdo pale tjetër përveç shtetit apo organizatës ndërkombëtare që nuk ka përmbushur detyrimet që ta përdorë shkeljen si bazë për pezullimin e fuqisë vepruese të traktatit në tërësi apo në pjesë përsa i përket vetes së saj nëse traktati ka një karakter të tillë që shkelja serioze e dispozitave të tij nga një palë ndryshon rrënjësisht pozicionin e çdo pale në lidhje me përmbushjen e mëtejshme të detyrimeve të saj sipas traktatit.

3. Një shkelje serioze e një traktati, për qëllimet e këtij neni, konsiston në:

a) mospranim të traktatit të pasanksionuar nga kjo Konventë; ose

b) shkeljen e një dispozite që është e rëndësishme për përmbushjen e objektit apo qëllimit të traktatit.

4. Paragrafët e mëparshëm nuk cenojnë asnjë dispozitë në traktatin e zbatueshëm në rast të ndonjë shkeljeje.

5. Paragrafët 1 deri në 3 nuk zbatohen për dispozitat që lidhen me mbrojtjen e njeriut të përfshira në traktatet me karakter humanitar, veçanërisht për dispozitat që ndalojnë çdo formë mase ndëshkimore kundër personave të mbrojtur nga traktate të tilla.

Neni 61

Pamundësia e përmbushjes

1. Një palë mund të përdorë pamundësinë e përmbushjes së një traktati si bazë për të përfunduar apo për t'u tërhequr nga traktati, nëse pamundësia rezulton nga zhdukja apo shkatërrimi i përhershëm i një objekti të domosdoshëm për ekzekutimin e traktatit. Nëse pamundësia është e përkohshme, ajo mund të përdoret vetëm si bazë për pezullimin e fuqisë së veprimit të traktatit.

2. Pamundësia e përmbushjes mund të mos përdoret nga një palë si bazë për përfundimin, tërheqjen apo pezullimin e fuqisë vepruese të një traktati, nëse pamundësia është rezultat i një shkeljeje nga ajo palë qoftë i një detyrimi të parashikuar në traktat apo i ndonjë detyrimi tjetër ndërkombëtar që i detyrohen çdo pale tjetër në traktat.

Neni 62

Ndryshimi rrënjësor i rrethanave

1. Një ndryshim rrënjësor i rrethanave që ka ndodhur në lidhje me rrethanat ekzistuese në kohën e realizimit të traktatit dhe që nuk ishte parashikuar nga palët, mund të mos përdoret si bazë për përfundimin apo tërheqjen nga traktati, në qoftë se:

a) ekzistenca e atyre rrethanave nuk përbënte një bazë të rëndësishme të pëlqimit të palëve për t'u kufizuar nga traktati; dhe

b) efekti i ndryshimit nuk do të thotë transformim rrënjësor i masës së detyrimeve ende për t'u përmbushur në bazë të traktatit.

2. Një ndryshim rrënjësor i rrethanave mund të mos përdoret si bazë për përfundimin apo tërheqjen nga një traktat midis dy apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare nëse traktati vendos një kufi.

3. Një ndryshim rrënjësor i rrethanave mund të mos përdoret si bazë për përfundimin e një traktati apo tërheqjen nga një traktat nëse ndryshimi rrënjësor është rezultat i një shkeljeje nga pala duke e përdorur atë qoftë si një detyrim i parashikuar në traktat, apo si çdo detyrim tjetër ndërkombëtar që i detyrohen çdo pale tjetër në traktat.

4. Në qoftë se, sipas paragrafëve të mëparshëm, një palë mund të përdorë një ndryshim rrënjësor të rrethanave si bazë për përfundimin apo tërheqjen nga një traktat, ajo gjithashtu mund të përdorë ndryshimin si bazë për pezullimin e fuqisë së veprimit të traktatit.

Neni 63

Ndarja e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore

Ndarja e marrëdhënieve diplomatike apo konsullore midis shteteve palë në një traktat midis dy apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare nuk ndikon në marrëdhëniet ligjore të vendosura midis atyre shteteve nga traktati, me përjashtim të rasteve kur ekzistenca e marrëdhënieve konsullore është e domosdoshme për zbatimin e traktatit.

Neni 64

Shfaqja e një norme të re të pakundërshtueshme e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme (*jus cogens*)

Nëse një normë e re e pakundërshtueshme e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme shfaqet, çdo traktat ekzistues që është në konflikt me atë normë bëhet i pavlefshëm dhe përfundon.

SEKSIONI 4. P ROCEDURAT

Neni 65

Procedurat që duhen ndjekur në lidhje me pavlefshmërinë, përfundimin, tërheqjen apo pezullimin e fuqisë vepruese të një traktati

1. Një palë, e cila sipas dispozitave të kësaj Konvente, përdor një të metë në pëlqimin e saj për t'u kufizuar nga një traktat apo një bazë për gjykimin e vlefshmërisë së një traktati, duke e përfunduar atë, duke u tërhequr prej tij apo duke pezulluar fuqinë e veprimit të tij, duhet t'i njoftojë palët e tjera për pretendimin e saj. Njoftimi do të tregojë masën e propozuar për t'u marrë në lidhje me traktatin dhe arsyet për këtë gjë.

2. Nëse pas mbarimit të periudhës, e cila me përjashtim të rasteve të urgjencave të veçanta, nuk duhet të jetë më pak se tre muaj pas marrjes së njoftimit, asnjë palë nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim, pala që ka bërë

njoftimin mund të kryejë në mënyrën e parashikuar në nenin 67 masën që ka propozuar.

3. Nëse, gjithsesi, kundërshtim është ngritur nga çdo palë tjetër, palët do të kërkojnë një zgjidhje përmes mjeteve të përcaktuara në nenin 33 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

4. Njoftimi apo kundërshtimi i bërë nga një organizatë ndërkombëtare do të rregullohet nga rregullat e asaj organizate.

5. Asgjë nga paragrafët e mëparshëm nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas dispozitave në fuqi që detyrojnë palët në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

6. Pa cenuar nenin 45, fakti që një shtet apo një organizatë ndërkombëtare nuk e ka bërë paraprakisht njoftimin e përshkruar në paragrafin 1, nuk do ta parandalojë atë nga bërja e këtij njoftimi në përgjigje ndaj një pale tjetër që pretendon përmbushje të traktatit ose shkeljen e tij.

Neni 66

Procedurat për zgjidhje, gjykim dhe pajtim gjyqësor

1. Nëse, sipas paragrafit 3 të nenit 65, nuk është arritur asnjë zgjidhje brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh që nga data kur është ngritur kundërshtimi, do të ndiqen procedurat e specifikuara në paragrafët e mëposhtëm.

2. Në lidhje me një mosmarrëveshje që ka të bëjë me zbatimin apo interpretimin e nenit 53 ose 64:

a) Nëse një shtet është palë në mosmarrëveshje me një apo më shumë shtete, ai mund të dorëzojë me anë të një kërkese me shkrim mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për të marrë një vendim;

b) Nëse një shtet është palë në mosmarrëveshjen në të cilën një apo më shumë organizata ndërkombëtare janë palë, shteti, përmes një shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara nëse është e nevojshme, mund t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme apo Këshillit të Sigurisë, apo aty ku është e përshtatshme organit kompetent të një organizate ndërkombëtare, e cila është palë e mosmarrëveshjes dhe është e autorizuar në përputhje me nenin 96 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, një mendim këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me nenin65 të statutit të Gjykatës;

c) Nëse Kombet e Bashkuara apo një organizatë ndërkombëtare, që është e autorizuar në përputhje me nenin 96 të Kartës së Kombeve të Bashkuara është një palë në mosmarrëveshje, ajo mund të kërkojë një mendim këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të drejtësisë në përputhje me nenin 65 të Statutit të Gjykatës;

d) Nëse një organizatë ndërkombëtare, përveç atyre që iu jemi referuar në nënparagrafin "c" është një palë në mosmarrëveshje, ajo përmes një shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara mund të ndjekë procedurën e specifikuar në nënparagrafin "b";

e) Mendimi këshillimor i dhënë sipas nënparagrafit "b", "c" ose "d" do të pranohet si vendimtar nga të gjitha palët e interesuara për mosmarrëveshjen;

f) Nëse kërkesa sipas nënparagrafëve "b", "c" ose "d" për një mendim këshillimor të Gjykatës nuk jepet, çdonjëra nga palët në mosmarrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim ndaj palës apo palëve të tjera mund ta dorëzojë atë në arbitrazh në përputhje me dispozitat e shtojcës në këtë Konventë.

3. Dispozitat e paragrafit 2 zbatohen nëse të gjitha palët në mosmarrëveshjen që i jemi referuar në atë paragraf me pëlqim të përbashkët nuk bien dakord të dorëzojnë mosmarrëveshjen në një procedurë gjykimi, duke përfshirë atë që specifikohet në shtojcën e kësaj Konvente.

4. Përsa i përket një mosmarrëveshjeje, që lidhet me zbatimin apo interpretimin e çdonjërit prej neneve në pjesën V, përveç neneve 53 dhe 64 të kësaj Konvente, çdo njëra nga palët në mosmarrëveshje mund të vërë në lëvizje procedurën e pajtimit të specifikuar në shtojcën e Konventës, duke i paraqitur një kërkesë për atë qëllim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 67

Instrumentet për deklarimin të pavlefshëm, përfundimin, tërheqjen apo pezullimin e fuqisë vepruese të traktatit

1. Njoftimi i parashikuar sipas nenit 65, paragrafi 1, duhet të bëhet me shkrim.

2. Çdo akt që deklaron të pavlefshëm, të përfunduar apo tërheqjen dhe pezullimin e fuqisë vepruese të traktatit në bazë të dispozitave të traktatit apo të paragrafëve 2 ose 3 të nenit 65 do të kryhet përmes një instrumenti që i është komunikuar palëve të tjera. Nëse instrumenti që buron nga një shtet nuk është firmosur nga kryetari i shtetit, kryetari i qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme, përfaqësuesit të shtetit mund t'i kërkohet të ushtrojë fuqi të plota. Nëse instrumenti buron nga një organizatë ndërkombëtare, përfaqësuesit të organizatës mund t'i kërkohet të ushtrojë fuqi të plota.

Neni 68

Revokimi i njoftimit dhe instrumentet e parashikuara në nenet 65 dhe 67

Një njoftim apo instrument i parashikuar në nenet 65 ose 67 mund të revokohet në çdo kohë para se të hyjë në fuqi.

SEKSIONI 5. PASOJAT E PAVLEFSHMËRISË, TË PËRFUNDIMIT APO PEZULLIMIT TË FUQISË VEPRUESE TË NJË TRAKTATI

Neni 69
Pasojat e pavlefshmërisë së një traktati

1. Një traktat, pavlefshmëria e të cilit është përcaktuar sipas kësaj Konvente, është i pavlefshëm. Dispozitat e një traktati të pavlefshëm nuk kanë forcë ligjore.

2. Nëse aktet janë kryer gjithsesi në mbështetje të këtij traktati:

a) çdo palë mund t'i kërkojë çdo pale tjetër të përcaktojë aq sa është e mundur në marrëdhëniet e tyre reciproke pozicionin që do të kishte ekzistuar nëse aktet nuk do të ishin kryer;

b) aktet e kryera në mirëbesim para se pavlefshmëria të konstatohej nuk bëhen të paligjshme për shkak vetëm të pavlefshmërisë së traktatit.

3. Në rastet që parashikohen sipas neneve 49, 50, 51 apo 52, paragrafi 2, nuk zbatohet në lidhje me palën ndaj të cilës mashtrimi, akti i korrupsionit apo shtrëngimi është me faj.

4. Në rastin e pavlefshmërisë së pëlqimit të një shteti apo një organizate ndërkombëtare të caktuar për t'u kufizuar nga një traktat shumëpalësh, rregullat e mëparshme zbatohen në marrëdhëniet midis shtetit apo asaj organizate dhe palëve të traktatit.

Neni 70
Pasojat e përfundimit të një traktati

1. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe apo nëse palët nuk bien dakord ndryshe, përfundimi i një traktati sipas dispozitave të tij ose në përputhje me këtë Konventë:

a) i liron palët nga çdo detyrim i mëtejshëm për të përmbushur traktatin;

b) nuk prek asnjë të drejtë, detyrim apo situatë ligjore të palëve të krijuara përmes ekzekutimit të traktatit para përfundimit të tij.

2. Nëse një shtet apo një organizatë ndërkombëtare prish marrëveshjen apo tërhiqet nga një traktat shumëpalësh, paragrafi 1 zbatohet në marrëdhëniet midis atij shteti ose asaj organizate dhe secilës prej palëve të tjera të traktatit nga data kur një prishje e marrëveshjes apo tërheqja hyn në fuqi.

Neni 71
Pasojat e pavlefshmërisë së një traktati që bie ndesh me normat e pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme

1. Në rastin e një traktati, i cili është i pavlefshëm sipas nenit 53, palët:

a) do të eliminojnë aq sa të jetë e mundur pasojat e çdo akti të kryer në mbështetje të çdo dispozite e cila bie ndesh me normat e pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme; dhe

b) do t'i bëjnë marrëdhëniet e tyre reciproke në përputhje me normat e pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme.

2. Në rastin e një traktati, i cili bëhet i pavlefshëm dhe përfundon sipas nenit 64, përfundimi i traktatit:

a) i liron palët nga çdo detyrim për të përmbushur më tej traktatin;

b) nuk prek asnjë të drejtë, detyrim apo situatë ligjore të palëve të krijuar përmes ekzekutimit të traktatit para përfundimit të tij; me kusht që ato të drejta, detyrime apo situatë mund të mbahen që këtej e tutje vetëm në atë masë që mirëmbajtja e tyre nuk është në vetvete në konflikt me normat e reja të pakundërshtueshme të së drejtës ndërkombëtare së përgjithshme.

Neni 72
Pasojat e pezullimit të fuqisë vepruese të një traktati

1. Nëse traktati nuk e parashikon ndryshe apo nëse palët nuk bien dakord ndryshe, pezullimi i fuqisë vepruese të traktatit sipas dispozitave të tij me këtë Konventë:

a) i liron palët midis të cilave fuqia vepruese e traktatit është pezulluar nga detyrimi për të përmbushur traktatin në marrëdhëniet e tyre reciproke gjatë periudhës së pezullimit;

b) nuk prek marrëdhëniet ligjore midis palëve të përcaktuara nga traktati.

2. Gjatë periudhës së pezullimit, palët do të shmangen nga aktet që tentojnë të pengojnë rifillimin e fuqisë vepruese të traktatit.

PJESA VI
DISPOZITA TË SHUMËANËSHME

Neni 73
Marrëdhënia e Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve

Ashtu si midis shteteve palë në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të 1969, marrëdhëniet e atyre shteteve sipas një traktati midis dy apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare do të rregullohen nga ajo Konventë.

Neni 74
Çështje që nuk cenohen nga kjo Konventë

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë asnjë çështje që mund të dalë në lidhje me një traktat midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare nga një varg shtetesh ose nga përgjegjësia ndërkombëtare e një shteti apo nga lindja e armiqësive midis shteteve.

2. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë asnjë çështje që mund të lindë në lidhje me një traktat nga përgjegjësia ndërkombëtare e një organizate ndërkombëtare, nga përfundimi i ekzistencës së organizatës apo nga përfundimi i pjesëmarrjes nga një shtet në anëtarësimin e organizatës.

3. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë ndonjë çështje që mund të dalë në lidhje me përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave për shtetet anëtare të një organizate ndërkombëtare sipas një traktati në të cilën ajo organizatë është palë.

Neni 75

Marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore dhe lidhja e traktateve

Ndarja apo mungesa e marrëdhënieve diplomatike apo konsullore midis dy apo më shumë shteteve nuk parandalon lidhjen e traktatit midis dy apo më shumë prej atyre shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare. Lidhja e një traktati të tillë nuk prek në vetvete situatën në lidhje me marrëdhëniet diplomatike apo konsullore.

Neni 76

Rasti i një shteti agresor

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë ndonjë detyrim në lidhje me një traktat midis një apo më shumë shteteve dhe një apo më shumë organizatave ndërkombëtare që mund të dalin për një shtet agresor si rrjedhojë e masave të marra në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me sulmin e atij shteti.

PJESA VII

DEPOZITARËT, NJOFTIMET, KORRIGJIMET DHE REGJISTRIMET

Neni 77

Depozitarët e traktateve

1. Përcaktimi i një depozitari të një traktati mund të bëhet nga shtetet negociatore dhe organizatat negociatore ose sipas rastit, organizatat negociatore si në vetë traktat, apo në ndonjë mënyrë tjetër. Depozitari mund të jetë një apo më shumë shtete, një organizatë ndërkombëtare apo zyrtari kryesor administrativ i organizatës.

2. Funksionet e depozitarit të një traktati janë ndërkombëtare në karakter dhe depozitari është nën një detyrim për të vepruar paanësisht në kryerjen e detyrës së tyre. Në veçanti, fakti që një traktat nuk ka hyrë në fuqi midis disa prej palëve apo që një ndryshim është shfaqur midis një shteti apo një organizate ndërkombëtare dhe një depozitari në lidhje me kryerjen e funksioneve të këtij të fundit nuk do ta prekë atë detyrim.

Neni 78

Funksionet e depozitarëve

1. Funksionet e një depozitari, nëse nuk janë parashikuar ndryshe në traktat apo nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga shtetet kontraktuese apo sipas rastit nga organizatat kontraktuese, janë:

a) të ruajë tekstin origjinal të traktatit dhe çdo fuqi të plotë që i është dhënë depozitarit;

b) të përgatisë kopje të certifikuara të tekstit origjinal dhe të përgatisë çdo tekst të më vonë të traktatit dhe t'ia transmetojë atë palëve dhe shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që iu është dhënë e drejta të jenë pjesë e traktatit;

c) të marrë çdo firmë të traktatit dhe të marrë dhe të ruajë çdo instrument, njoftim dhe komunikim të lidhur me të;

d) të kontrollojë nëse firma apo çdo instrument, njoftim apo komunikim që lidhet me traktatin është në formën që duhet dhe nëse nevojitet të çojë çështjen në vëmendjen e shtetit apo organizatës ndërkombëtare në fjalë;

e) të informojë palët dhe shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që iu është dhënë e drejta të bëhen palë në traktatin e akteve, njoftimeve dhe komunikimeve të lidhura me traktatin;

f) të informojë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që iu është dhënë e drejta të bëhen palë në traktat kur numri i firmave apo instrumenteve të ratifikimit, instrumente që lidhen me një akt të konfirmimit formal, apo të instrumenteve të pranimit, aprovimit apo aderimit të kërkuar për hyrjen në fuqi të traktatit të jenë marrë apo depozituar;

g) të regjistrojë traktatin në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara;

h) të kryejë funksionet e specifikuara në dispozita të tjera të kësaj Konvente.

2. Në rast të çdo ndryshimi që shfaqet midis një shteti apo një organizate ndërkombëtare dhe depozitarit për kryerjen e funksioneve të këtij të fundit, depozitari do ta çojë çështjen në vëmendjen e:

a) shteteve nënshkruese dhe organizatave dhe shteteve kontraktuese dhe organizatave kontraktuese; ose

b) aty ku është e përshtatshme, të organit kompetent të organizatës ndërkombëtare të interesuar.

Neni 79

Njoftimet dhe komunikimet

Vetëm në rastet kur traktati apo kjo Konventë e parashikon ndryshe, çdo njoftim apo komunikim që është për t'u bërë nga çdo shtet apo çdo organizatë ndërkombëtare sipas kësaj Konvente:

a) nëse nuk ka ndonjë depozitar, do t'u transmetohet direkt shteteve dhe organizatave për të cilat është menduar, ose nëse ka një depozitar do t'i transmetohet këtij të fundit;

b) do të konsiderohet sikur është bërë nga shteti apo organizata përsa i përket vetëm marrjes nga shteti apo organizata së cilës i është transmetuar ose sipas rastit, përsa i përket marrjes së tij nga depozitari;

c) nëse i përcillet një depozitari, do të konsiderohet sikur është marrë nga shteti apo organizata për të cilat është menduar vetëm kur shteti i fundit apo organizata është informuar nga depozitari në përputhje me nenin 78, paragrafi 1 "e".

Neni 80

Korrektimi i gabimeve në tekste apo në kopje të certifikuara të traktatit

1 Nëse pas vërtetimit të origjinalitetit të tekstit të traktatit, shtetet nënshkruese dhe organizatat ndërkombëtare, shtetet kontraktuese dhe organizatat kontraktuese bien dakord që ajo përmban një gabim, gabimi duhet të korrigjohet nëse vetë shtetet dhe organizatat nuk kanë gjetur mjete të tjera korrigjimi:

a) duke bërë korrigjimin e duhur në tekst dhe duke bërë siglimin e korrigjimit nga përfaqësuesit e duhur të autorizuar;

b) duke bërë ekzekutimin apo shkëmbimin e një instrumenti apo instrumentesh duke përcaktuar korrektimin për të cilin është rënë dakord; ose

c) duke ekzekutuar një tekst të korrektuar të të gjithë traktatit nga e njëjta procedurë si në rastin e tekstit origjinal.

2. Kur bëhet fjalë për një traktat për të cilin ka një depozitues, ky i fundit do të lajmërojë shtetet kontraktuese dhe organizatat ndërkombëtare si dhe shtetet dhe organizatat kontraktuese për gabimin dhe për propozimin për ta korrigjuar atë dhe do të specifikojë një limit kohe të përshtatshëm brenda të cilit mund të ngrihet një kundërshtim ndaj korrigjimit të propozuar. Nëse me mbarimin e afatit kohor:

a) nuk është ngritur asnjë kundërshtim, depozitari do të bëjë dhe do të siglojë korrigjimin në tekst dhe do të ekzekutojë një procesverbal të korrigjimit të tekstit dhe t'i komunikojë një kopje të tij palëve, shteteve dhe organizatave që kanë të drejtën të jenë palë në traktat;

b) është ngritur një kundërshtim, depozitari do t'ia komunikojë kundërshtimin shteteve dhe organizatave nënshkruese, si edhe shteteve dhe organizatave kontraktuese.

3. Rregullat në paragrafin 1 dhe 2 zbatohen gjithashtu aty ku teksti është vërtetuar në dy apo më shumë gjuhë dhe duket se ka një mungesë përputhjeje të cilën shtetet nënshkruese dhe organizatat ndërkombëtare si dhe shtetet dhe organizatat kontraktuese bien dakord që duhet ta korrigjojnë.

4. Teksti i korrektuar zëvendëson tekstin me gabime *ab initio* (nga fillimi), nëse shtetet nënshkruese dhe organizatat kontraktuese nuk kanë vendosur ndryshe.

5. Korrektimi i tekstit të një traktati që është regjistruar duhet t'i bëhet me dije Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

6. Nëse gjendet një gabim në një kopje të certifikuar të një traktati, depozitari do të ekzekutojë një procesverbal që specifikon rregullimin e gabimeve dhe ia komunikon një kopje të tij shteteve nënshkruese dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe shteteve dhe organizatave kontraktuese.

Neni 81

Regjistrimi dhe publikimi i traktateve

1. Traktatet pas hyrjes së tyre në fuqi duhet t'i transmetohen Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, për t'u skeduar apo publikuar sipas rastit.

2. Caktimi i një depozitari do të përbëjë autorizimin për të kryer aktet specifike në paragrafin e mëparshëm.

PJESA VIII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 82

Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri në 31 dhjetor 1986 në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme të Republikës së Austrisë dhe rrjedhimisht deri në 30 qershor 1987, në Njësitë Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga:

a) të gjitha shtetet;

b) Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë;

c) organizatat ndërkombëtare të ftuara për të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Traktateve midis Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare apo midis Organizatave Ndërkombëtare.

Neni 83

Ratifikimi ose akti i konfirmimit formal

Konventa aktuale është subjekt i ratifikimit nga shtetet dhe nga Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe i akteve të konfirmimit formal nga organizata ndërkombëtare.

Instrumentet e ratifikimit dhe ato që lidhen me aktet formale të konfirmimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 84

Aderimi

1. Kjo Konventë do të mbetet e hapur për aderim nga çdo shtet, nga Namibia e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe nga çdo organizatë ndërkombëtare e cila ka aftësinë për të lidhur traktatet.

2. Një instrument i aderimit të një organizate ndërkombëtare do të përmbajë një deklaratë që ajo ka aftësinë për të lidhur traktate.

3. Instrumentet e aderimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 85
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë e pestë të ratifikimit apo të aderimit nga shtetet apo nga Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë.

2. Për secilin shtet apo për Namibinë të përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, ratifikimi apo aderimi në Konventë pasi kushtet e specifikuara në paragrafin 1 janë përmbushur, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të shtetit përkatës ose nga Namibia.

3. Për çdo organizatë ndërkombëtare që depoziton një instrument në lidhje me një akt të konfirmimit formal apo një instrument të aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas këtij depozitimi, ose në datën kur Konventa hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 1, cilido qoftë më i voni.

Neni 86
Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente, teksti i së cilës edhe në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle është njësoj autentik, do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të asaj që u tha më sipër, nënshkruesit fuqiplotë, të autorizuar sipas rregullit nga qeveritë e tyre përkatëse dhe përfaqësuesit e autorizuar të Këshillit të Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe të organizatave ndërkombëtare, nënshkruan këtë Konventë.

Vjenë, më njëzet e një mars, një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë.

SHTOJCË
PROCEDURAT E ARBITRAZHIT DHE TË PAJTIMIT, TË PËRCAKTUARA NË ZBATIM TË NENIT 66
I. NGRITJA E GJYKATËS SË ARBITRAZHIT OSE KOMISIONIT TË PAJTIMIT

1. Një listë e përbërë nga juristë të kualifikuar, nga e cila palët në mosmarrëveshje mund të zgjedhin personat që do të jenë pjesë e Gjykatës së Arbitrazhit ose sipas rastit pjesë e komisionit të pajtimit, do të hartohet dhe do të mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe çdo palë në këtë Konventë do të ftohet që të zgjedhë dy persona dhe emrat e personave që do zgjidhen në këtë formë do të përbëjnë listën, një kopje e së cilës do t'i përcillet Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kohëzgjatja e ndenjes në detyrë të një personi në listë, duke përfshirë edhe një person të zgjedhur për të mbushur një vend vakant, do të jetë pesë vjet dhe mund të rinovohet. Një person, mandati i të cilit mbaron, do të vazhdojë të përmbushë çdo funksion për të cilin është zgjedhur sipas paragrafëve të mëposhtëm.

2. Kur njoftimi është bërë sipas nenit 66, paragrafi 2, nënparagrafi "f", apo është arritur një marrëveshje sipas procedurës në këtë shtojcë sipas paragrafit 3, mosmarrëveshja do të çohet përpara një gjykate arbitrazhi. Kur Sekretarit të Përgjithshëm i bëhet një kërkesë sipas nenit 66, paragrafi 4, ky i fundit do ta çojë mosmarrëveshjen para një komisioni pajtimi. Si gjykata e arbitrazhit, dhe komisioni i pajtimit do të ketë përbërjen e mëposhtme:

Shtetet, organizatat ndërkombëtare apo sipas rastit, shtetet dhe organizatat që përbëjnë një prej palëve në mosmarrëveshje do të caktojnë me pëlqim të përbashkët:

a) një arbitër ose sipas rastit, një pajtues, që mund ose jo të jetë zgjedhur nga lista që iu referuam në paragrafin 1; dhe

b) një arbitër ose, sipas rastit një pajtues, që do të jetë zgjedhur nga ata që janë të përfshirë në listë dhe nuk do të jenë me kombësi nga asnjë nga shtetet apo i zgjedhur nga ndonjë organizatë e cila përbën palën në mosmarrëveshje me kushtin që një mosmarrëveshje midis dy organizatave ndërkombëtare të mos konsiderohet nga shtetasit e një dhe e të njëjtit shtet.

Shtetet, organizatat ndërkombëtare apo sipas rastit, shtetet dhe organizatat të cilat përbëjnë palën tjetër në mosmarrëveshje do të caktojnë dy arbitra ose sipas rastit dy pajtues, në të njëjtën mënyrë. Të katër personat e zgjedhur nga palët do të caktohen brenda gjashtëdhjetë ditëve nga dita kur pala tjetër në mosmarrëveshje merr njoftim sipas nenit 66, paragrafi 2, nënparagrafi "f", ose për të cilën sipas paragrafit 3 një marrëveshje është arritur sipas procedurës në këtë shtojcë sipas paragrafit 3 ose për të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka marrë kërkesën për pajtim.

Të katër personat e zgjedhur në këtë mënyrë, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga dita e fundit e zgjedhjes së tyre, do të zgjedhin nga lista një arbitër të pestë ose sipas rastit një pajtues, i cili do të jetë kryetar.

Nëse emërimi i një kryetari apo i çdo njërit prej arbitrave ose sipas rastit pajtuesve, nuk do të jetë bërë brenda periudhës së përshkruar më lartë për emërime të tilla, ai do të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara brenda gjashtëdhjetë ditëve pas mbarimit të kësaj periudhe. Emërimi i kryetarit mund të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, nga lista ose nga anëtarësimi në Komisionin Ndërkombëtar të Ligjeve. Çdo periudhë, brenda së cilës duhet të jenë bërë emërimet, mund të zgjatet me marrëveshje midis palëve në mosmarrëveshje. Nëse Kombet e Bashkuara janë palë ose janë përfshirë në një prej palëve në mosmarrëveshje, Sekretari i Përgjithshëm do t'ia përcjellë kërkesën e

mësipërme Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili do të kryejë funksionet e dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm sipas këtij nënparagrafi.

Vendet vakante do të plotësohen ashtu siç është përshkruar në emërimin fillestar.

Emërimi i arbitrave ose i pajtuesve nga një organizatë ndërkombëtare e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2 do të rregullohet nga rregullat e asaj organizate.

II. FUNKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

3. Nëse palët në mosmarrëveshje nuk kanë rënë dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë procedurat e saj, duke i siguruar çdo pale në mosmarrëveshje një mundësi të plotë për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur rastin e saj.

4. Gjykata e Arbitrazhit, me pëlqimin e palëve në mosmarrëveshje, mund të ftojë çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare të interesuar për të dorëzuar pikëpamjet e tij/saj me shkrim apo me gojë.

5. Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të pranohen me një votë mazhoritare të anëtarëve. Në rast të një barazie votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

6. Kur një prej palëve në mosmarrëveshje nuk paraqitet përpara Gjykatës ose dështon në mbrojtjen e çështjes së saj, pala tjetër mund t'i kërkojë Gjykatës të vazhdojë procedurën dhe të japë vendimin e saj. Para se të japë vendimin, Gjykata duhet të sigurojë veten e saj jo vetëm që ajo ka juridiksion mbi mosmarrëveshjen, por gjithashtu që kërkesa është e bazuar në fakte dhe në ligj.

7. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit do të kufizohet me lëndën e mosmarrëveshjes dhe të tregojë arsyet mbi të cilat ajo është bazuar. Çdo anëtar i Gjykatës mund të bashkëngjisë një opinion të ndarë apo kundërshtues ndaj vendimit.

8. Vendimi do të jetë përfundimtar dhe pa mundësi apelimi. Ai do të jetë në pajtueshmëri me të gjitha palët në mosmarrëveshje.

9. Sekretari i Përgjithshëm do t'i japë Gjykatës ndihmën dhe lehtësirat e nevojshme. Shpenzimet e Gjykatës do të përballohen nga Kombet e Bashkuara.

III. FUNKSIONI I KOMISIONIT TË PAJTIMIT

10. Komisioni i pajtimit do të vendosë procedurën e tij. Komisioni, me pëlqimin e palëve në mosmarrëveshje, mund të ftojë çdo palë në traktat të japë mendimet e saj me shkrim apo me gojë. Vendimet dhe rekomandimet e komisionit do të merren nga një shumicë votash e pesë anëtarëve.

11. Komisioni mund të tërheqë vëmendjen e palëve në mosmarrëveshje ndaj çdo mase që mundëson një zgjidhje miqësore.

12. Komisioni do të dëgjojë palët, do të shqyrtojë ankesat dhe kundërshtimet dhe do t'u bëjë propozime palëve me qëllim arritjen e një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes.

13. Komisioni do të raportojë brenda dymbëdhjetë muajve të konstituimit të tij. Raporti i tij do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm dhe do t'u përcillet palëve në mosmarrëveshje. Raporti i komisionit, përfshirë çdo konkluzion të nxjerrë aty që lidhet me faktet apo çështjet ligjore, nuk do të jetë detyrues për palët dhe nuk do të ketë karakter tjetër përveç atij të rekomandimeve të dorëzuara për marrjen parasysh të palëve me qëllim lehtësimin e një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes.

14. Sekretari i Përgjithshëm do t'i sigurojë komisionit gjithë ndihmën dhe lehtësirat e nevojshme. Shpenzimet e komisionit do të përballohen nga Kombet e Bashkuara.

LIGJ
Nr. 22/2014

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja "ë", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë udhëhiqet nga parimet e humanizmit, arritjes së qëllimit të dënimit, rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen, si dhe mbrojtjes së interesit publik.

Neni 2
I dënuar

I dënuar, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet personi i dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 3
Kriteret për përfitimin e amnistisë

Plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas këtij ligji:

a) personat e dënuar me burgim deri në 3 vjet, personat e dënuar me kusht, me gjobë apo personat, për të cilët gjykata ka caktuar një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31 dhjetor 2013, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

b) personat e dënuar, gra, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

c) personat e dënuar, burra, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

ç) personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre, që janë dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 101, 139, 140 e 141 të Kodit Penal.

Neni 4

Kushtet për dhënien e amnistisë nga vuajtja e dënimit

Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, u amnistohet:

a) 1,5 vjet, për personat e dënuar, gra, dhe të miturve në kohën e kryerjes së veprës penale;

b) 1 vit për personat e dënuar, burra.

Neni 5

Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale

Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët deri në datën 31dhjetor 2013 kanë kryer vepra penale, të cilat parashikojnë një dënim në maksimum deri në dy vjet burgim ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, me përjashtim të veprave të parashikuara në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 6

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Pavarësisht nga parashikimet e nenit 3, nuk përfitojnë personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75, të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83/a, 83/b, 84, 84/a dhe 85 të Kodit Penal, dhe vrasje e mbetur në tentativë, si dhe nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;

c) vepra penale, të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, paragrafi i dytë i nenit 88, 89/a dhe 99 të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, paragrafi i dytë e i tretë i nenit 109/b, 109/c, paragrafi i dytë i nenit 110, 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114 dhe në paragrafin e dytë e të tretë të nenit 117 të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, paragrafin e tretë të nenit 124/b, nenet 128/a, 128/b dhe 130/a të Kodit Penal;

ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135, 136, 137, paragrafi i dytë i nenit 137/a, paragrafi i dytë i nenit 138, 138/a, 139, 140, 141, paragrafi i dytë i nenit 141/a, paragrafi i dytë i nenit 143, 143/a, 143/b, 144/a, paragrafi i tretë i nenit 152, 175, paragrafi i dytë dhe i tretë të nenit 180 dhe nenin 181/a të Kodit Penal, si dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;

f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në nenet 186, 189 dhe 191 të Kodit Penal;

g) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në nenet 206/a dhe 206/b të Kodit Penal;

gj) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;

h) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;

i) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;

j) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 250, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 266, 270, paragrafi i parë, i katërt dhe i pestë të nenit 278, 278/a, paragrafi i dytë i nenit 279, paragrafi i dytë i nenit 282, 282/a, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, paragrafi i dytë i nenit 289, 290, si dhe paragrafi i dytë, i tretë, i katërt dhe i pestë të nenit 298 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;

k) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal;

l) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 330/a, 331 dhe 332 të Kodit Penal;

ll) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

2. Nuk përfitojnë nga parashikimet e nenit 5 të këtij ligji personat që kanë kryer vepra penale të parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 137, neni 182, neni 197, paragrafi i parë i nenit 197/a, paragrafi i parë i nenit

235, paragrafi i parë i nenit 236 dhe neni 291 të Kodit Penal.

Neni 7
Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal.

Neni 8
Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Mbrojtjes dhe Prokurori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8523, datë 24.3.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

URDHËR
Nr. 1, datë 26.3.2014

PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 29, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenet 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti, të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit në lidhje me proceset gjyqësore dhe Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

3. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Kuvendit të Shqipërisë, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

4. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese, bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1/personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/ gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.

7. Përfaqësimi ligjor i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjykimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Sekretari i Përgjithshëm

LIDHJA 1

Nr. ___ prot. (vendndodhja), më __ . _ .2014

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN ADMINISTRATIVE/CIVILE ME PALË:

Paditës/Kërkues: ……
E paditur/Subjekt i interesuar: ……
Objekti: ……

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", si dhe të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. 1, datë 26.3.2014, "Për delegimin dhe rregullat e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë",

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj ……, me detyrë ……, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/gjykimit në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në

(gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse)/ Gjykatën Kushtetuese.

(Sekretari i Përgjithshëm)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 28 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006